

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
K&H Konstruksion SHPK**

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot më datë 11.12.2024, në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me vullnetin e plotë dhe të lirë, unë ortaku i vetëm i shoqërisë:

Znj.Dajana Velçani, lindur dhe banuese në Berat, e datëlindjes 11.06.1998 dhe shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me letër njoftim me nr. Personal J85611002B miraton statutin dhe akt themelimin e shoqërisë si vijon:

Themelohet shoqëria tregtare K&H Konstruksion SHPK e cila do t'i nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij statuti dhe akt themelimi.

Shoqëria rregullon poziten e saj juridike, marrëdhëniet me ortakun e vetëm, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj, llojin e shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e shoqërive tregtare.

Neni 1

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria K&H Construction SHPK ka si objekt veprimtarinë e mëposhtme:

Punime të specializuara ndërtimi që kryhen dhe me nënkontraktorë. Veshja e mureve me sistem kapot, hidroizolim i taracave, shtrim me parket dhe të tjera veshje druri të dyshemeve, veshja e murit me elementë druri, shtrim pllakash, lyerje të objekteve të banimit, lyerje fasada, montim të artikujve të mobilierisë, restaurim objekteve të banimit, punime me gips, etj. Veshje të dyshemesë me mokete dhe linoleum, përfshirë gomën ose plastikën. Veshje muri me terrakotë, mermer, granit ose gurë, veshje me letër muri. Montimi i strukturave metalike dhe shtrim i tullave dhe vendosja e gurëve. Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit. Punime për fasadat e ndërtesave etj..

Kryerja e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare për sa parashikohet me ligj dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj ekonomike.

Neni 2

Emri dhe selia e shoqërisë

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar. Shoqëria fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj K&H Konstruksion SHPK. Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

2.3 Selia e Shoqërisë tregtare K&H Konstruksion SHPK do të jetë në adresën: Rr. Thoma Koxhaj, Pallati Ales, Shkalla 1, Apartamenti nr. 6, Tiranë.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike e tregtare të shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për reflektimin sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Neni 4

Regjimi Juridik i Shoqërisë

4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Shoqëria tregtare K&H Konstruksion SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Veprimtaria i nënshtrohet dispozitave të aktit të themelimit, statutit si dhe dispozitave të legjislacionit shqiptar tregtar e atij civil për sa nuk parashikohet në aktin e themelimit dhe në statutin e shoqërisë. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të themelimit dhe të statutit të saj, duke bërë dhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Me vendim të organeve vendimmarrëse të shoqërisë, shoqëria K&H Konstruksion SHPK mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

4.2 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

4.3 Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ortakut

5.1 Ortaku mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

5.2 Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

5.3 Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin kuotën e tyre në kapitalin shoqërisë, në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.

Neni 6

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (një mijë) lekë, kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e funksionimit të shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakut në vlerën 1.000 (një mijë) lekë.

Kuotat e kapitalit janë të ndara në 1 pjesë të barabarta me vlerë nominale 1,000 (një mijë) lekë sejcila me kontributin e ortakut si më poshtë:

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në lekë
Dajana Velçani	100%	1	1,000

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke u vendosur rritja e vlerës së kuotës së ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga ortaku, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Neni 10

Fondi rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj.

Neni 11

Administrimi

11.1 Asambleja e Përgjithshme emëron si administrator të shoqërisë K&H Konstruksion SHPK znj. Dajana Velçani. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

11.2 Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të emërojë një administrator tjetër nëse e gjykon të nevojshme.

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ligjin për pronarin përfitues;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe akt themelimi.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut hartohet dhe firmoset në 3 (tre) kopje origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

O R T A K U
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
K&H Konstruksion SHPK

Dajana Velçani

